

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 14 TETOR 2021

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë,

Në fakt, nuk është hera e parë dhe nuk do të jetë as hera e fundit që Presidenti kthen për shqyrtim ligje shumë të rëndësishme për vendimmarrje, të cilat marrin kohë dhe pengojnë zhvillimet rutinë që duhet të ndodhin në një kohë kaq të vështirë me të cilën po përballemi. Prej një viti e gjysmë qeveria shqiptare ka reaguar në mënyrë të menjëhershme për t'i përballuar të gjitha sfidat që i ranë në një moment të vështirë dhe në një kohë shumë të shkurtër. Sigurisht, sot, me treguesit në shifra, qoftë ata të rritjes ekonomike, të punësimit apo edhe të të ardhurave, shifrat janë kokëforta dhe tregojnë të kundërtën e asaj që është parashikuar, madje janë edhe më mirë sesa vetë parashikimet e Ministrisë së Financave. Megjithatë, në dekret Presidenti flet për kredibilitet dhe për raport FMN-je. Çfarë thotë FMN-ja? Po t'i bëjmë referencë të gjithë tekstit, edhe kolegët pak më parë e përmendën, FMN-ja thotë: "Politikat luajtën rol kyç në ruajtjen e jetës, duke i hapur rrugë zhvillimit të ekonomisë". Në shifra flitet për një rritje ekonomike mbi 8% për vitin korrent, nga 5% që kishte parashikuar Ministria e Financave, flitet për një recesion, i cili u tkurr në gjysmën e parashikimit të Ministrisë së Financave; flitet për punësim, i cili ka arritur dhe tejkaluar nivelin e parakrizës; flitet për një kredibilitet të qëndrueshmërisë së financave publike të matura nga institucione si MOOD-i dhe Standard and Poor, të cilët për 2 vjet e kanë vlerësuar Shqipërinë si të qëndrueshme në aspektin e financave publike.

Atëherë, për ç'arsye kthehet ligji shumë i rëndësishëm i buxhetit të shtetit, ku flitet konkretisht për të rritur investimet, për të ndihmuar vaksinimin, për t'i ndihmuar shqiptarët për të paguar bonusin e qirasë deri sa të shkojnë në banesat e tyre? Nuk besoj se ka sot shqiptarë që flasin për nevojën dhe urgjencën më shumë sesa ata që duan të vaksinohen, të shkojnë në shtëpitë e tyre, të shkojnë dhe të kalojnë rrugët e vështira qoftë në zonat rurale, qoftë në qendrat urbane. Prandaj është shumë e rëndësishme që të gjitha fondet e akorduara në infrastrukturë të shihen jo vetëm si një mundësi për të lehtësuar jetën e qytetarëve, por njëkohësisht për të rritur ekonominë e këtij vendi, ku shifrat janë kokëforta dhe ku efektiviteti i tyre ka treguar rezultat konkret. Pak më parë këtu u përmend se si aktet normative, të cilat këtë vit ishin 4 në raport me buxhetin, nuk ndihmojnë parashikueshmërinë. Ndërkohë, flasim për një vit jonormal, për një vit, i cili në 3 nga këto akte normative ka pasur në qendër vaksinimin, si dhe për akte normative, të cilat i vijnë në kohë reale zhvillimit ekonomik të këtij vendi. Flitet për rritje të borxhit për një periudhë afatshkurtër kohe, për t'iu kthyer konsolidimit fiskal, pasi konsolidimi fiskal nuk ndodh automatikisht, por ndodh me rritjen e të ardhurave, të konsumit dhe mbi të gjitha me rritjen e ekonomisë. Ne nuk jemi vendi as i parë dhe as i fundit që në një moment të vështirë të situatës me të cilën po përballemi të rrisim deficitin dhe borxhin për t'iu kthyer konsolidimit fiskal. Konsolidimi fiskal do të realizohet, sepse kjo qeveri ka treguar që sa herë e ka dhënë fjalën, e ka mbajtur. Kështu ka bërë edhe në vitin 2019, ku pasi e mori borxhin publik në 70% e çoi në 66% dhe kështu do të bëjë edhe në këtë mandat qeverisës, duke u siguruar të gjithë shqiptarëve jo vetëm një mirëqenie dhe punësim më të rritur, por edhe një konsolidim fiskal në afat të mesëm. Shumë faleminderit!

